

UNMIK/REG/2008/9
8 shkurt 2008

RREGULLORE NR. 2008/9

MBI
NDRYSHIMIN E KORNIZËS KUSHTETUESE PËR VETËQEVERISJE
TË PËRKOHSHME

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP),

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren e ndryshuar nr. 1999/1 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) të datës 25 korrik 1999 mbi autorizimin e Administratës së Përkohshme në Kosovë dhe Rregulloren nr. 2001/9 të UNMIK-ut të datës 15 maj 2001 mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme),

Duke marrë parasysh komunikatën nga kryetari i Kuvendit të Kosovës, të datës 7 shkurt 2008, dorëzimin e mocionit për PSSP-në të miratuar nga Kuvendi me shumicë të kërkuar prej dy të tretave më 31 janar 2008 mbi ndryshimin e nenit 9.1.7 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme,

Duke vepruar në pajtim me nenin 14.3 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme,

Me anë të kësaj shpall ndryshimin e Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme të paraqitur në Aneksin e kësaj Rregulloreje:

Kjo Rregullore hyn në fuqi më datën 8 shkurt 2008.

Joachim Rücker
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm

ANEKSI**NDRYSHIMI I KORNIZËS KUSHTETUESE PËR VETËQEVERISJE TË PËRKOHSHME**

Neni 9.1.7 i Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme ndryshohet si vijon:

(1) Fjalja hyrëse është si vijon:

“9.1.7 Kuvendi ka një kryesi e cila përbëhet prej nëntë anëtarve të Kuvendit, të cilët zgjedhen si vijon:”;

(ii) Shtohet një nënparagraf i ri (e) pas nënparagrafit ekzistues (d) si vijon:

“(e) Një anëtar emërohet nga partia ose koalicioni që ka fituar vendin e pestë për nga numri i votave në zgjedhjet për Kuvend;”;

(ii) Nënparagrafët ekzistues (e) dhe (f) rinumërohen si (f) dhe (g).

Për rrjedhojë, neni 9.1.7 ka këtë riformulim duke filluar nga data 8 shkurt 2008:

“9.1.7 Kuvendi ka një kryesi e cila përbëhet prej nëntë anëtarve të Kuvendi të cilët përzgjedhen si vijon:

(a) Dy anëtarë emërohen nga partia ose koalicioni që ka fituar numrin më të madh të votave në zgjedhjet për Kuvend;

(b) Dy anëtarë emërohen nga partia ose koalicioni që ka fituar vendin e dytë për nga numri i votave në zgjedhjet për Kuvend;

(c) Një anëtar emërohet nga partia ose koalicioni që ka fituar vendin e tretë për nga numri i votave në zgjedhjet për Kuvend;

(d) Një anëtar emërohet nga partia ose koalicioni që ka fituar vendin e katërt për nga numri i votave në zgjedhjet për Kuvend;

(e) Një anëtar emërohet nga partia ose koalicioni që ka fituar vendin e pestë për nga numri i votave në zgjedhjet për Kuvend;

(f) Një anëtar emërohet nga anëtarët e Kuvendit të cilët u takojnë atyre partive që janë deklaruar përfaqësues të komunitetit të serbëve të Kosovës;

(g) Një anëtar emërohet nga anëtarët e Kuvendit të cilët u takojnë atyre partive që janë deklaruar përfaqësues të komunitetit joshqiptar dhe të komunitetit joserb të Kosovës. Metoda e emërimit të këtij anëtari përcaktohet nga anëtarët e Kuvendit të cilët u takojnë këtyre komuniteteve.”